



Pranuar / Dorezuar Primjetet/Prodato Received/Delivery	29.12.2022	2	viti god year
Organ/Njësia Organ/Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKVINSIK	8608/2022		119



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1092/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësi të procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1092/2022 të datës 02.12.2022 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ kundër organit të punësimit Shërbimit Korrektues të Kosovës në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 29.12.2022 mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1092/2022 e datës 02.12.2022 e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_
- II. Shfuqizohet Vendimit i Udhëheqësit për Siguri në Qendrën e Paraburgimit në Prizren i datës të 01.11.2022
- III. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi, \_\_\_\_\_ sipas shkresave të lëndës i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, me datë 30.11.2022 nëpërmjet poste ka parashtruar ankesë, e cila në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil është pranuar me datë 02.12.2022 dhe është regjistruar me numër protokolli: 7598/2022, kundër Vendimit të datës 01.11.2022 të Udhëheqësit për Siguri në Qendrën e Paraburgimit në Prizren.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshill, pretendon se Udhëheqësi për Siguri në Qendrën e Paraburgimit në Prizren me rastin e shqiptimit të masës disiplinore-vërejtje ka zbatuar gabimisht dispozitat e ligjit material pasi që nuk është udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë, sikurse nuk është konstatuar drejtë gjendja faktike ngase i njëjti nuk ka kryer shkelje disiplinore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Shërbimin Korrektues të Kosovës. Këshilli, me datë 09.12.2022 me numër protokollit 7841/2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave me qëllim të vendosjes meritore ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 02.12.2022 me numër protokollit 7598/2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Zarin Postar të datës 30.11.2022; Vendimin e datës 01.11.2022 të Udhëheqësit për Siguri në Qendrën e Paraburgimit në Prizren; E-mailin e datës 09.12.2022 dërguar nga Xh.I për këshillin me shkresat e lëndës; Shkresën e datës 09.12.2022 me numër:1305; Kontratën e punës së ankuesit të datës 02.07.2018; Përshkrimin e detyrave të punës së ankuesit; Vlerësimin e rezultateve në punë të ankuesit i datës 21.01.2022; Formularin e vlerësim it të rezultateve në punë i datës 03.12.2020; vërejtjen e datës 12.07.2016 ndaj ankuesit; Raporti i përfundimit të hetimeve i datës 17.10.2022 Shkresën e datës 05.10.2022 i titulluar Urdhër për fillim të hetimeve; E-mailin e datës 05.10.2022 dërguar nga Sh.K për B.V; E-mailin e datës 05.10.2022 dërguar nga B.G për Sh.K; Raportin e datës 03.10.2022; Shkresën e datës 07.10.2022 dërguar nga A.B; Shkresën e datës 07.10.2022 dërguar nga G.K; Informatën e datës 07.10.2022 dërguar nga ankuesi; Informatën e datës 07.10.2022 dërguar nga Z.A; Informatën e datës 07.10.2022 dërguar nga V.K; Informatë e datës 07.10.2022 ora 14:00 me korrespondencën e bashkangjitur prej njëzetë e një (21) faqesh.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar që ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të provave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë ka konstatuar se ankuesi marrëdhënien e punës në Shërbimin Korrektues të Kosovës në pozitën "Zyrtar Korrektues në Qendrën e Paraburgimit në Prizren" e të themeluar mbi bazën e Ligjit Nr.04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale si dhe Ligji Nr. 03/1-212 të Punës e përcaktuar sipas kontratës së punës të datës 02.07.2018.

Me Ligjin Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik i zbatueshëm nga data 09.07.2020 sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese Nr.ref.1583/20 të datës 09.07.2020 përkatësisht me nenin 4 paragrafi 1 është përcaktuar se: *Nëpunësit profesional të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë*", nga rrjedh se me hyrjen në fuqi të këtij ligji, nëpunësit e shërbimit korrektues kanë statusin e nëpunësve civilë me status të veçantë, respektivisht me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë, themelimi, ndryshimi, përfundimi i marrëdhënies së punës si dhe çdo e drejtë dhe detyrim nga marrëdhënia e punës për zyrtarët e shërbimit korrektues i nënshtrohet dispozitave të këtij ligji për kategorinë e nëpunësve civil dhe ligjit të veçantë për shërbimin korrektues të përcaktuar sipas nenit 4 paragrafi 2, nën paragrafët 2.1; 2.2; 2.3 dhe 2.4 ku caktohet se: "2. Rregullimi me ligj të veçantë, sipas paragrafit



1 të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm këto elemente të marrëdhënies së punës: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve", nga rrjedh se çështja e shqiptimit të masave disiplinore nuk mund të rregullohet ndryshe nga siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe akteve nënligjore që rrjedhin prej tij.

Kolegji, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë neni 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe neni 48 paragrafi 1 ku përcaktohet: "1. Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë" dhe ka ardhur në përfundimin se pretendimi ankimor i ankuesit është i bazuar ngase duke u bazuar në formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2021 i datës 21.01.2022, del se zyrtari i cili ia ka shqiptuar ankuesit masën disiplinore-vërejtje, gjegjësisht Shefi për Siguri në Qendrën e Paraburgimit në Prizren nuk është Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit.

Po ashtu Kolegji ka analizuar dispozitat e nenit 7 paragrafi 1, 4 dhe 5 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë ku përcaktohet se: "1. Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejtë në rastet kur vihet në dijeni të një pretendimi për shkelje disiplinore, nëpërmjet ankesave nga qytetarët apo institucione jashtë strukturave të institucionit, e vlerëson paraprakisht atë. 4. Në rast se informacioni i marrë rezulton të ketë elemente si shkelje disiplinore, Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë bën kualifikimin e shkeljeve sipas nenit 46 të Ligjit. 5. Në rast se shkelja klasifikohet sipas nenit 46 paragrafi 4 nën paragrafët 4.1 deri 4.4 të Ligjit, Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë fillon procedurën disiplinore sipas nenit 48 paragrafit 2 të Ligjit.", nga rrjedh se pretendimi ankimor i ankuesit për shkelje esenciale procedurale në rastin konkret është i bazuar, ngase përveçse masa disiplinore-vërejtje është shqiptuar nga zyrtari jo kompetentë, për të njëjtën masë nuk është bërë kualifikimi sipas deponitave ligjore të ligjit material të përcaktuar me nenin 46 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 dhe 2.2 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë, ngase në bazë të kualifikimit të shkeljes ku përcaktohet se a është shkelje e lehtë apo shkelje e rëndë, rrjedh edhe kompetenca e shqiptimit të masës ndërmjet komisionit disiplinor apo udhëheqësit të drejtpërdrejtë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në bazë të provave të lëndës, konstatimeve të dhëna në arsyetimin e këtij vendimi, si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka konstatuar se Vendimi i Udhëheqësit për Siguri në Qendrën e Paraburgimit në Prizren i datës 01.11.2022 është akti i paligjshëm siç përcaktohet edhe me nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.5 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative: Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: Organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë " dhe 1.5 është në kundërshtim me ligjin material", ngase në rastin konkret masa disiplinore ankuesit i është shqiptuar nga organi jo kompetent dhe institucioni punëdhënës i ka zbatuar gabimisht apo nuk i ka zbatuar fare dispozitat Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuesit.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda me A.nr.1092/2022**

**Flakron GASHI**

*[Signature]*  
Zyrtarë i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Malsore GASHI-BAJRAKTARI**

*[Signature]*  
Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesi
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK- së.

